

L I G J
Nr.8045, datë 7.12.1995

PËR NDËRPRERJEN E SHTATËZËNËSISË
(ndryshuar me ligjin nr. 57/2013, datë 14.2.2013; nr. 99/2024, datë 12.9.2024)
(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ligji garanton respektimin e çdo qenie njerëzore që në fillim të jetës. Ky parim nuk shkelet, përveç rasteve kur është e domosdoshme dhe në kushtet e përcaktuara në këtë ligj.

Mbrojtja e këtij parimi, informimi për problemet e jetës dhe demografisë kombëtare, edukimi i përgjegjësive sociale, pranimi i fëmijës në shoqëri dhe politika familjare janë detyrime kombëtare. Organet e pushtetit qendror dhe lokal i realizojnë këto detyrime dhe mbështetin çdo nismë që ndihmon për realizimin e tyre.

Neni 2

Parimet mbi të cilat bazohet ky ligj janë:

1. Shërbimi shëndetësor i të gjitha niveleve duhet të përdorë shërbimet e planifikimit familjar, si mjet për të shmangur shtatëzënësitë e padëshiruara. Ndërprerja e shtatëzënësisë nuk do të konsiderohet në asnjë rast si metodë e planifikim familjar.

2. Gruaja ka të drejtën e informacionit të saktë dhe këshillimit përpara ndërprerjes së shtatëzënësisë.

3. Në rastet kur ndërprerja e shtatëzënësisë nuk është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, ajo duhet të kryhet në kushte të sigurta për shëndetin e gruas.

4. Në të gjitha rastet grave duhet t’u sigurohet shërbim shëndetësor për trajtimin e ndërlikimeve të mundshme pas ndërprerjes së shtatëzënësisë.

5. Këshillimi dhe shërbimi i planifikimit familjar pas ndërprerjes së shtatëzënësisë duhet të jetë i menjëhershëm, me qëllim që të shmangen shtatëzënësitë e padëshiruara.

6. Ndërprerja e shtatëzënësisë lejohet vetëm kur vërtetohen rrethana të padëshiruara në këtë ligj dhe në çdo rast me pëlqimin e gruas.

KREU II
NDËRPRERJA E SHTATËZËNËSISË

Neni 3

Ndërprerja e vullnetshme e shtatëzënësisë bëhet vetëm nga mjeku specialist obstetër-

ginekolog në institucione shëndetësore shtetërore e private që plotësojnë kushtet e përcaktuara në udhëzimin përkatës të ministrit të Shëndetësisë.

Neni 4

Mjeku të cilit i kërkohet ndërprerja e vullnetshme e shtatëzënisë, që në vizitën e parë duhet të informojë gruan për:

1. Rreziqet mjekësore që sjell ndërprerja e shtatëzënisë për shtatëzënesitë e ardhshme, si dhe problemet biologjike të ndërhyrjes mjekësore.
2. Të drejtat, ndihmën dhe avantazhet e garantuara me ligj për familjen, nënën dhe fëmijën, si dhe për mundësitë e adoptimit të fëmijëve që priten të lindin.
3. Institucionet dhe organizmat që mund t'i ofrojnë gruas mbështetje morale dhe financiare.
4. Klinikat dhe spitalet që kryejnë ndërprerje të shtatëzënisë.

Neni 5

Ministri i Shëndetësisë përcakton me udhëzim të veçantë përmbajtjen, mënyrën e hartimit dhe shpërndarjes së materialeve udhëzuese me informacionet e parashikuara në nenin 4.

Neni 6

Në rast se gruaja, pas marrjes së informacionit të përmendur në nenin 4, përsërit kërkesën e saj për ndërprerjen e shtatëzënisë, mjeku kërkon konfirmimin me shkrim të kërkesës. Ky konfirmim kërkohet pasi të kenë kaluar të paktën 7 ditë nga kërkesa e parë.

Kur është e mundur, në këshillimin dhe marrjen e vendimit për ndërprerjen e shtatëzënisë, merr pjesë edhe bashkëshorti ose prindi.

Në rast se afati prej 7 ditësh bën që të tejkalohen afatet e përcaktuara në këtë ligj, mjeku mund të vendosë që ky afat të jetë të paktën 2 ditë.

Neni 7

Në rast konfirmimi, mjeku kryen ndërprerjen e shtatëzënisë në kushtet e përcaktuara në nenin 3. Kur mjeku të cilit i drejtohet kërkesa nuk është ai që do të kryejë ndërhyrjen, atëherë kërkesa i kthehet gruas bashkë me një vërtetim mbi respektimin e procedurave të nenit 4 dhe 6 për t'i paraqitur te mjeku që do të kryejë ndërprerjen e shtatëzënisë.

Institucioni shtetëror apo privat ku pranohet gruaja, duhet të përfshijë në kartelën e saj kërkesën dhe vërtetimin për respektimin e procedurave.

Neni 8

Në rast shtatëzënie jashtë martese në vajza të mitura deri 16 vjeç, përveç kërkesës së saj, për ndërprerjen e shtatëzënisë kërkohet miratimi i personit që ushtron autoritetin prindëror ose e kujdestarit ligjor të saj.

Kërkesa e vetë vajzës duhet të bëhet pa praninë e personave të përmendur në paragrafin e mësipërm.

Të martuarat në moshë të mitur u nënshtrohen dispozitave të nenit 7 të këtij ligji.

Neni 9

Ndërprerja e shtatëzënisë për arsye mjekësore mund të bëhet deri në javën e 22 të shtatëzënisë, në rast se një komision i përbërë nga 3 mjekë, pas ekzaminimit dhe konsultimit, gjykon se vazhdimi i shtatëzënisë dhe/ose lindja e fëmijës rrezikon jetën ose shëndetin e gruas.

Kur komisioni gjykon se fetusi ka keqformime të papajtueshme me jetën, apo sëmundje invaliduese me trajtim të pasigurtë, vendos për ndërprerjen e shtatëzënisë në çdo kohë.

Ministri i Shëndetësisë përcakton me udhëzim të veçantë rastet e përmendura në paragrafin e parë të këtij neni, si dhe kushtet që duhet të plotësojnë mjekët e komisionit.

Neni 10

Në rastet kur gruaja vlerëson se shtatëzënia i krijon probleme psikosociale, ndërprerja e vullnetshme mund të kryhet brenda javës së 12 të shtatëzënisë.

Neni 11

Ndërprerja e shtatëzënisë për arsye sociale bëhet brenda javës së 22, në rast se një komision i përbërë nga 3 specialistë, mjekë, punonjës socialë, juristë, pas ekzaminimit dhe konsultimit, gjykon se shtatëzënia është rezultat i përdhunimit ose një krimi tjetër seksual, si dhe kur vërtetohen arsye të tjera sociale.

Udhëzimi për trajtimin e këtyre rasteve dhe përbërjen e komisionit miratohet nga ministri i Shëndetësisë.

Neni 12

Të gjitha ndërprerjet e shtatëzënisë duhet të bëhen objekt i një deklarimi të konfirmuar nga mjeku që kryen ndërprerjen, i cili dërgohet nga institucioni në Institutin e Statistikës. Të dhënat për ndërprerjet e shtatëzënisë dërgohen nga institucioni shëndetësor shtetëror e privat në Ministrinë e Shëndetësisë, sipas udhëzimeve përkatëse.

Deklarimi dhe informacionet e tjera nuk duhet të përmbajnë identitetin e gruas.

Neni 13

Të gjitha këshillimet e grave detyrohen t'u japin grave që kërkojnë të ndërprerë shtatëzëninë, informacionin dhe këshillat e parashikuara në këtë ligj dhe në akte të tjera nënligjore për zbatimin e tij.

Neni 14

Në të gjitha rastet e ndërprerjes së shtatëzënisë, mjeku që i kryen ato është i detyruar të informojë gratë për shërbimet e planifikimit familjar dhe t'i këshillojë për metodat kontraceptive që ofron institucioni ku ai punon dhe/ose institucione të tjera shtetërore e private.

KREU III DISPOZITA TË VEÇANTA

Neni 15

Ndalohet çdo lloj propagande dhe reklamimi, direkt ose indirekt, me fjalë ose figurë, e institucioneve, metodave, medikamenteve e produkteve që shkaktojnë ndërprerje të shtatëzënisë, përveç se në botimet shkencore të destinuara për mjekë dhe farmacistë.

Neni 16

Asnjë mjek nuk mund të detyrohet të kryejë ndërprerje të shtatëzënisë kundër vullnetit

të tij.

Neni 17

(ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 57/2013, datë 14.2.2013; ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

Shkelja e dispozitave të parashikuara në nenet 4, 6, 7, 12, 13, 14 dhe 16 të këtij ligji, kur nuk përbën vepër penale, dënohet si kundërvajtje administrative me gjobë nga 50 mijë deri në 100 mijë lekë.

Shkelja e dispozitave të parashikuara në nenin 15 dënohet me gjobë deri në 100 mijë lekë.

Gjoha jepet nga trupa inspektuese e strukturës përgjegjëse për inspektimin në shëndetësi në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

Neni 17/1

Inspektimi

(shtuar me ligjin nr. 57/2013, datë 14.2.2013; hequr fjalë me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore që burojnë nga ky ligj kryhet nga inspektorati që mbulon fushën e shëndetit në përputhje me këtë ligj dhe ligjin “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 18

(ndryshuar me ligjin nr. 57/2013, datë 14.2.2013)

1. Ankimi ndaj vendimit të inspektoratit bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.
2. Ekzekutimi i vendimeve bëhet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Neni 19

Këshilli i Ministrave miraton tarifat shtetërore për ndërprerjet e shtatëzënësive.

Neni 20

Të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Dispozitë kalimtare

(e ligjit nr. 57/2013, datë 14.2.2013)

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.1331, datë 22.12.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Sali Berisha**